



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:156638
Datë: 21.07.2023
Numri i dokumentit: 04509240

CN.nr.236/16

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Shyqri Hoxha, me bashkëpunëtorin profesional A.K. në çështjen juridike jo kontestimore të propozuesit H.K. nga fshati Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson av. H.C. nga Prizreni, ndaj kundër propozuesve S.K., F. K., F.K., D.K. dhe Sh.K. të gjithë nga fshati Komuna e Prizrenit, me objekt të propozimit ndarje fizike të tokës, me datën 21 korrik 2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. NDËRPRITET procedura në këtë çështje juridike jo kontestimore lidhur me ndarjen fizike të tokës, për shkak të zgjidhjes së çështjes paraprake.

II. Procedura e ndërprerë do të vazhdojë sipas propozimit të palëve, e pas përfundimit të procedurës kontestimore me shenjë C.nr.1177/16.

A r s y e t i m

Propozuesi H.K. nga fshati Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson av. H.C. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datën 28 prill 2016, ka parashtruar propozimin për ndarje fizike të tokës ndaj kundër propozuesve S.K., F. K., F.K., D.K. dhe Sh.K të gjithë nga fshati Komuna e Prizreni.

Me datën 17.07.2023, gjykata ka caktuar shqyrtimin gjyqësor në të cilën shqyrtim kundërpropozuesi S.K. ka deklaruar se e njofton gjykatën se për parcelat të cilat janë pjesë e këtij propozimi për ndarje fizike është duke u zhvilluar procedura kontestimore pranë kësaj gjykate me padi vërtetim pronësie e cila evidentohet me numër të lëndës C.nr.1177/16, ku për të njëjtën janë mbajtur seanca dhe është dalur në teren me ekspertin e gjeodezisë, ku gjykatës i ka dëshmuar si provë padinë, andaj duke marrë parasysh se është çështje paraprake e cila ka të bëjë me vërtetimin e pronësisë, i ka

propozuar gjykatës që kjo procedurë të ndërpritet pasi që është duke u zhvilluar procedura kontestimore për të njëjtën çështje.

Andaj, duke marr parasysh të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 13 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) i cili ligj zbatohet në bazë të nenit 3 të LPJK-së , ngase gjeti se procedura kontestimore me numër C.nr.1177/16, paraqitet të jetë çështje paraprake pa përfundimin e të cilës gjykata nuk mund të vazhdojë me këtë procedurë.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
CN.nr.236/16, me datë 21 korrik 2023

B.profesional
Ali Kosova

Gjyqtari
Shyqri Hoxha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas marrjes të njëjtit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet kësaj gjykate.